

KROÇERA “ARION” SJELL 200 TURISTË NGA FRANCA, BELGJIKA, BRITANIA E MADHE DHE SHBA

-Deri në shtator anija turistike do të ankorohet në Durrës edhe 17 herë të tjera me afro 6000 turistë gjithsej-

Në portin detar të Durrësit kanë mbërritur sot 200 turistë të huaj. Nga kroçera “Arion”, e cila nën kudesin e APD u ankorua në kalatën 5 zbritën turistë të moshave të ndryshme nga Franca, Belgjika, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Forca e Sigurisë Portuale FSP krijoi të gjitha kushtet për të lehtësuar trafikun në sheshin pranë kalatës.

Turistët e ndarë në grupe udhëtuan më pas me autobuzë drejt qyteteve të Tiranës dhe Krujës, ndërsa një pjesë po vazhdojnë vizitat në qendrat arkeologjike dhe muzeale të qytetit antik të Durrësit. Kroçera “Arion” ka mbërritur nga porti i Kotorrit (Mali i Zi) dhe sot në mbrëmje do të vijojë lundrimin e saj turistik drejt Italisë.

Anija turistike me flamur portugez dhe port regjistrimi Madeirën deri në fund të muajit shtator do të kryejë edhe 17 lundrime të tjera drejt Durrësit në kuadër të një itinerari turistik në portet e vendeve që lagen nga deti Adriatik.

“Arion” vjen në Durrës për të tretin vit radhazi dhe numri i lundrimeve është rritur nga viti në vit. Përveç një pauze trejavore në mes të muajit gusht, kroçera me flamur portugez do të të ankorohet në portin më të madh të vendit edhe 17 herë të tjera duke sjellë në vendin tonë rreth 6 mijë turistë nga vende të ndryshme perëndimore.

Autoriteti Portual i Durrësit APD ka marrë të gjitha masat për krijimin e kushteve lehtësuese për ankorimin e kroçerave, jahteve dhe motoskafeve me turistë, të cilët zgjedhin të vizitojnë qytetin bregdetar të Durrësit dhe portin më të madh të vendit.

Durrësi është bërë vitet e fundit një nga stacionet e përhershme të itinerareve ballkanike dhe mesdhetare. Dy javë më parë kroçera “Cristina Regina” solli në qytetin bregdetar për një vizitë 12-orëshe 207 turistë nga vendet skandinave.

Gjatë këtij sezoni veror tureve të mëparshme ballkanike dhe mesdhetare i është shtuar edhe një udhëtim turistik 10-ditor në portet e qyteteve të Italisë, Kroacisë, Malit të Zi dhe Shqipërisë, të cilat lagen nga deti Adriatik.

Operatorët turistikë shqiptarë parashikojnë një rritje prej më shumë se 30 përqind të numrit të turistëve të huaj krahasuar me vitin 2009.



